

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	GJKKO rrëzon kërkesën e Ilir Metës, lihet në - Syri Lajmi i fundit
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/916765/gjkkko-rrezon-kerkesen-e-ilir-metes-lihet-ne-paraburg-im-s-lejohet-te-dale-as-nga-kafazi-i-qelqte-ne-kete-gjykate/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHÀ


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:41:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:26:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a60f872285eb81882db62f2a5cefa1848f083cda8369270c198c7a4c5516c0af
TEKSTI	8ccd6ad029c948ae27e1336e93a13e8d1baff4d1d1645cc81fe2a01a28c8ccd0
PAMJA	5f87354e018af7e34d27cb6b22806a4d0d6b3c344e7e97d73e4f34ea23f7d755

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72319471efa1d612e8850f262e54fd9ce270586df09f61528b7e48177c774108
E MËPARSHMJA	df08a6ccdf1f015ee6b0c0834d9c881b007ff4a21e882d336d9cedbf61ac857e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72319471efa1d612e8850f262e54fd9ce270586df09f61528b7e48177c774108>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën



më të lexuarat

'Rama jepe dorëheqjen!' Tiranë zgjohet me protesta, policia shoqëron 7 protestues

Trafikonin sasi të mëdha kokaine/ Goditet banda shqiptare në Belgjikë, arrestohet Gert 'Gjenerali'

Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve

Shpërthim në Shijak! Zbulohet emri i pronarit të banesës ku u vendos eksplozivi

Si u rrëzua banda shqiptare e trafikantëve nga imazhi i një luani i krijuar me IA

Si arriti të fitonte lirinë Lulzim Caka në Shqipëri! Emri me të cilin jetonte në Greqi, çfarë u zbulua në vilën e tij luksoze



GJKKO rrëzon kërkesën e Ilir Metës, lihet në paraburgim! S'lejohet të dalë as nga kafazi i qelqtë në këtë gjykatë

12:26, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



GJKKO nuk ka pranuar të ndryshojë masën e sigurisë për presidentin e Partisë së Lirisë, Ilir Meta.

Ai do të vijojë të qëndrojë nën masën e 'arrestit me burg'

Ndryshe nga Apeli i GJKKO-së, GJKKO nuk ka pranuar kërkesën e Metës që gjatë procesit gjyqësor të qëndrojë jashtë kafazit të qelqtë përkrah avokatit të tij.

Meta ndodhet në paraburgim prej tetorit 2024. Partia e Lirisë ka denoncuar 'persekutimin politik' që po i bëhet presidentit të tyre me urdhër të kryeministrit Edi Rama.

Gazetari i Syrit, Fatjon Gjinaj informon detaje nga seanca sot.

Pati debat gjyqësor për rreth 2 orë e 30 minuta prej orës 10 të mëngjesit dhe deri tani, por përkundër pretendimeve të avokatëve se nuk ekzistojnë kushtet për ta mbajtur zotin Meta në paraburgim por me një masë më të lehtë sigurie, dhe përballë kërkesës së organit të akuzës së posaçme që nuk duhet të ndryshojë masa e sigurisë, togat e zeza vlerësuan dhe vendosën që zoti Meta të qëndrojë në paraburgim.

Çështja penale ndaj ish-presidentit të Republikës, aktualisht president i Partisë së Lirisë, forcës së dytë më të madhe opozitare, është duke vijuar në themel, një gjykim që ka nisur prej disa kohësh, ku zoti Meta akuzohet për disa dosje dhe çështje penale, përfshirë çështjen e lobimit apo të pasurisë dhe që është në fazën e gjykimit në themel.

Ai i ka mohuar vazhdimisht akuzat e për më tepër u është drejtuar me disa kërkesa të gjitha shkallëve të gjyqësorit për ndryshimin e masës së sigurisë duke e konsideruar joproporcionale në raport jo vetëm me, sipas mbrojtësve të tij, pretendimet e SPAK dhe akuzat e ngritura ndaj tij, por edhe me rrethanat në të

cilat ai ndodhet.

Ndërkohë që gjatë kohës në paraburgim, zoti Meta ka bërë një sërë ankesash publike por edhe institucionale sa i takon kushteve në mbajtjen e tij në paraburgimin 313 ku i ndalohet takimi me familjarë, përfshirë edhe për t'u konsultuar në mënyrë juridike me ekspertë të fushës apo për të dhënë deklarata apo intervista televizive apo mediatike, por edhe sa i takon trajtimit dhe kushteve që ka në tërësi sipas ankesave të tij paraburgimi i 313-ës që është edhe një burg i sigurisë së lartë.

Kanë reaguar dhe një sërë institucioneve lidhur me kushtet me të cilat ai mbahet në burg, përfshirë edhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, i cili në disa raste ka evidentuar pas inspektimeve situatën e rëndë të theksuar në raportet e saj në të cilat mbahet ish-kreu i shtetit.

Tashmë me kërkesën që u rrëzua sot në shkallën e parë, Meta pritet të shfrytëzojë natyrisht edhe hallkat e tjera të gjyqësorit për të ankimuar masën e sigurisë që është në fuqi prej tetorit 2024.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Arratisje si në filma/ Forcat speciale spanjolle arrestojnë shqiptarin me ... mbi 80 precedentë penalë



Laboratori i heroinës në Has dhe dosja '339', arrestohet në Belgjikë Jasmin Avdyli! Fitimet i investoi në dy lokale në Shijak



Arrestohet në flagrancë një efektivi policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë

Trafikanti shqiptar i shpëton burgut: Partnerja ka depresion dhe dhimbje kronike

Arrestimi i Gert 'Gjeneralit'/ Kokaina në Shqipëri u kap nga Europol, ishte fshehur në një kontejner

Alarmi për bombë në një shkollë në Tiranë rezultoi fals, arrestohet një person/ EMRI

TË NGJASHME



Arrestimi i Gert 'Gjeneralit'/ Kokaina në Shqipëri u kap nga Europol, ishte fshehur në një kontejner



Shpërthim në Shijak! Zbulohet emri i pronarit të banesës ku u vendos eksplozivi



Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve



Trafikonin sasi të mëdha kokaine/ Goditet banda shqiptare në Belgjikë, arrestohet Gert 'Gjenerali'



Ngjarja që tronditi Gjermaninë/ Torturuan 14-vjeçarën dhe e filmuan, mes autorëve edhe shqiptarë



GJKKO jep vendimin për fraksionin e dosjes 'Revanshi'! Ja sa u dënuan Durim Bami dhe 6 të tjerët



Shqiptarët dhe katër kompani shqiptare në qendër të hetimit për shfrytëzimin e fuqisë punëtore në Itali

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net